



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AKADEMIA E SHKENCAVE  
Kryesia

704584

Tiranë, <sup>21</sup>\_\_7.2023

Vendim nr. <sup>40</sup>\_\_ datë <sup>17</sup>\_\_7.2023

**Për themelimin e çmimit të veçantë shkencor *Shuteriqi*  
për botimet dokumentare**

Referuar nenit 7 pika 8 të Ligjit nr. 53/2019 *Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë* dhe nenit 25 pika 8 të Statutit të saj;

Mbështetur në nenin 10 të rregullores *Për çmimet shkencore që akordohen nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe për mënyrën e organizimit të konkursve të tyre*;

Referuar nenit 11 pika 3 të rregullores sipërcituar, me propozim të SSHSHA dhe të komisionit organizues të konferencës shkencore ndërkombëtare *Shteti i Arbërit dhe Arbëria në shekujt e humanizmit europian*, Kryesia e Akademisë së Shkencave, në mbledhjen e saj të datës 17.7.2023, vendosi:

1. Në kuadër të konferencës shkencore ndërkombëtare *Shteti i Arbërit dhe Arbëria në shekujt e humanizmit europian*, që organizohet në 555-vjetorin e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, që do të mbahet më 8-10 tetor 2023, të themelohet çmimi i veçantë *Shuteriqi*, që akordohet për botimet dokumentare-burimologjike dhe filologjike më të suksesshme për historinë, gjuhën, kulturën, trashëgiminë dhe identitetin shqiptar;

2. Në konkurs të pranohen vepra të botuara nga autorë e institucione nga viti 2001 dhe vijim, duke përfshirë vitin 2022; me burime dhe dokumente që i përgjigjen kohës prej themelimit të *Shtetit të Arbërit* (1210) deri në *Kuvendin e Arbënit* (1703), duke përfshirë ngjarjet që pasuan gjatë atij shekulli, përveç veprave fituese të çmimeve që akordohen nga ASHSH në konkurse të mëparshme dhe ribotimeve;

3. Në përfundim të vlerësimit të veprave të paraqitura juria merr vendim për dhënien e një çmimi të parë dhe të një çmimi të dytë;
4. Fituesit kanë të drejtën e diplomës, pllaketës dhe të një shpërblimi të arsyeshëm;
5. Përbërja e jurisë së vlerësimit të veprave në konkurrim për çmimin e veçantë *Shuteriqi* të jetë si në shtjocën bashkëlidhur;
6. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen: juria, SSHSHA, kancelari;
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Akad. Skënder GJINUSHI

KRYETAR

